

Бр.-Nr. 08-348/1
09.03.2022 год./viti



Republika e Maqedonisë së Veriut

Komuna e Tearcës

Republika e Kosovës

Komuna Hani i Elezit

Duke pasur parasysh Ligjin për Bashkëpunim Ndërkomunal të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Qeverisjen Lokale të Komunave të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Kosovës, në bazë të bashkëpunimit reciprok, objektivave dhe specifikave të dy Komunave të Tearcës dhe të Komunës së Hanit të Elezit, lidhim këtë:

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

KOMUNËS SË TEARCËS, REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT, E PËRFAQËSUAR NGA

KRYETARI I KOMUNËS Z.NUHI NEZIRI

DHE

KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT, REPUBLIKA E KOSOVËS, E PËRFAQËSUAR NGA

KRYETARI I KOMUNËS Z.MEHMET BALLAZHI

Në pajtim edhe me principet e bashkëpunimit të ndërsjelltë në nivel nacional dhe lokal dhe me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm përmes avancimit të bashkëpunimit tej kufitarë të vetëqeverisjes lokale;

Komuna e Tearcës nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Komuna e Hanit të Elezit nga Republika e Kosovës janë pajtuar për një bashkëpunim të partneritetit të ndërsjelltë për projektet në këto sfera:



- Përsheptimi i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.
- Inkurajimi i bashkëpunimit tejkuftar për avancimin e cilësisë së jetës dhe ambientin jetësor.
- Bashkëpunimin e ndërsjelltë në zhvillimin e turizmit dhe arritjen e standardeve ekologjike të BE-së.
- Promovimi i kohezionit social dhe menaxhimi me pasuritë dhe resurset natyrore.
- Aktivitete të përbashkëta projektuese në fushën e zhvillimit, arsimit, sportit, shkëmbimit kulturor dhe përforcimin e kapaciteteve institucionale.
- Bashkëpunim i ndërsjelltë dhe këmbimi i përvojave në krijimin e strategjive dhe studimeve të lidhura me zhvillimin ekonomin të dy komunave.
- Promovimi dhe prezantimi i kapaciteteve të komunave për investime me qëllim të zhvillimit të përsheptuar ekonomik.

Dy kryetarët janë pajtuar për partneritet dhe konkurrim për implementimin e projekteve Evropiane të zhvillimit përmes fondeve të instrumentit ndihmës parahyrës IPA për bashkëpunim tej kufitar.

Për këtë qëllim, kryetarët e komunave do të formojnë ekipe të sektorëve të tyre për zhvillim lokal ekonomik, të cilat do të jenë aktivë në fushën e zhvillimit dhe komunikimit për projekte të përbashkëta nga sfera që janë dakorduar me këtë memorandum.

Lidhur me datë: 9 mars 2022

Kryetari i Komunës së Tearcës
Nuhi Neziri



Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit
Mehmet Ballazhi

